

BANKA E SHQIPËRISË DHE INTEGRIMI
EUROPIAN

Shkëlqim Cani
Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Të nderuar Guvernatorë dhe pjesëmarrës në këtë tryezë,

Shqipëria, ashtu si dhe vendet e tjera të rajonit, ndan të njëjtin objektiv, integrimin europian. Ndërsa ky mund të konsiderohet si një objektiv strategjik, ndoshta afatgjatë, është e domosdoshme që të përpunohen dhe të ndiqen objektiva më afatmesëm gjatë kësaj faze tranzitore. Në dekadën që lamë pas, Shqipëria dhe Ballkani në tërësi, në njëfarë mënyre, u bënë pjesë e Europës nëpërmjet emigracionit.

Axhenda e reformave u dominua nga problemet e tranzicionit ekonomik, të vështira për t'u zgjidhur dhe mjaft komplekse në optimizimin e vendimmarrjeve. Objektivat tona të integrimit, të cilat duket se do të dominojnë në axhendën e veprimeve në dekadën në vazhdim, duhet të synojnë në europianizimin e shoqërisë në rajonin tonë.

Në këto procese, ekzistojnë hapësira që çdo anëtar i shoqërisë, çdo institucion apo organizim shoqëror, të ketë thënien dhe kontributin e tij. Dëshiroj të ndalem në vijim, në rolin që do të luajë Banka e Shqipërisë në procesin e integrimit europian të vendit.

Duke zhvilluar këtë koncept së pari brenda vetes, **modeli institucional** që Banka e Shqipërisë ka zgjedhur të zhvillojë, është

ai i Bankës Qendrore Europiane. Ky angazhim është shprehur në dokumentin "Strategjia e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, që në vitin 1999. Ne jemi të ndërgjegjshëm, që arritja e një kompatibiliteti në praktikën dhe standardet e bankës sonë qendrore me ato europiane, do të kërkojë kohën e nevojshme. Ato do të zhvillohen dhe përsosën paralelisht me zhvillimin ekonomik të vendit dhe shkallën e demokratizimit të të gjithë shoqërisë shqiptare.

Në etapat e para të tranzicionit, politikën monetare dhe valutore kufizoheshin nga mungesa e tregjeve financiare, e instrumenteve indirekte të politikës monetare, një bankë qendrore e sapokrijuar dhe pa eksperiencë, deficite të mëdha buxhetore dhe nevoja për një përshtatje të shpejtë të çmimeve relative. Megjithatë marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me buxhetin e shtetit, për shembull, nuk janë në nivelin e tyre të gjysmës së parë të viteve '90, ku deficiti financohej kryesisht me kredi direkte, ato janë ende larg praktikave të Bankës Qendrore Europiane.

Ne akoma financojmë drejtpërdrejt një pjesë të deficitit buxhetor. Praktika të tilla, të përcaktuara në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", dëshmojnë se edhe vetë legjislativi për bankën qendrore, ka nevojë që gradualisht të harmonizohet me legjislativin për sistemin e bankave qendrore europiane. Nga ana tjetër, zhvillimi i pavarësisë institucionale të Bankës së Shqipërisë, kërkon veç të tjerash, ekzistencën e një publiku mbështetës dhe të një tregu financiar, që përçon me korrektësi dhe shpejtësi sinjalet e politikave monetare në ekonomi. Unë konstatoj me kënaqësi, që Banka e Shqipërisë, nëpërmjet dhënies së opinioneve të saj të pavarura, për gjendjen e zhvillimit të ekonomisë apo për çështje të tjera të rëndësishme të ekonomisë së vendit, ka filluar të tërheqë vëmendjen e publikut.

Adresimi i këtyre çështjeve, ashtu si dhe përsosjet e brendshme strukturore dhe zhvillimi i kapaciteteve analitike brenda institucionit tonë, përbëjnë boshtin e dokumentit të Strategjisë që sapo përmenda më lart.

Proceset transformuese ekonomike të derisotme, kanë kontribuar në thellimin e **konvergjencës drejt strukturave ekonomike** e tregtare me ato të Bashkimit Europian. Shkëmbimet ekonomike, në mbi 80 për qind të tyre, sot zhvillohen me vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Në po këto nivele qëndron dhe origjina e investimeve të huaja në Shqipëri.

Është e natyrshme që thellimi i konvergencës të çojë në thellimin e ndërvarësisë ekonomike, duke rritur kështu simetrinë e goditjeve ekonomike. Për rrjedhojë, zhvillimet ekonomike dhe monetare në zonën e Bashkimit Europian do të jenë me më shumë efekte dhe në zhvillimet ekonomike e monetare të vendit. Në këtë kuptim, ne sot i kushtojmë më shumë vëmendje monitorimit të tyre dhe përshtatjes së vendimeve tona politike në përputhje me to.

Kërkimet empirike, megjithëse akoma të kufizuara, kanë provuar se zhvillimet në ciklin e biznesit në zonën e Bashkimit Europian, ndryshimet në kurset e këmbimit dhe ndryshimet e normave të interesave, kanë ndikim në ekonominë shqiptare⁸⁹. Për rrjedhojë, vendimet e Bankës Qendrore Europiane po shërbejnë gjithnjë e më shumë si ankorë e vendimeve të politikës sonë monetare.

Dalja në qarkullim e monedhës së re europiane në muajin e ardhshëm, përbën pa dyshim një zhvillim mjaft të rëndësishëm jo vetëm thjesht për Europën, por për gjithë sistemin financiar ndërkombëtar. Banka e Shqipërisë po i kushton një rëndësi të posaçme këtij evenimenti, së pari, nëpërmjet një fushate informuese të publikut, për të siguruar zëvendësimin, pa shqetësime, të monedhave europiane që janë në qarkullim. Për këtë qëllim, ne kemi bashkëpunuar ngushtë me bankat qendrore të zonës së euros si dhe me sistemin bankar të vendit. Në një perspektivë më afatgjatë, Banka e Shqipërisë është e angazhuar në studimin e shkallës së përdorimit të euros në ekonominë shqiptare si dhe të përgatitjes graduale për të lëvizur drejt ERM-2. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe përsosja e instrumenteve indirekte të politikës monetare si dhe adoptimi, brenda një kohe të përshtatshme, i regjimit të ri të politikës monetare të *'inflation target'*.

Në procesin e përgatitjes së vendit për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe në Bashkimin Monetar Europian, ne po i kushtojmë një vëmendje të veçantë përmbushjes së kriterëve normative të përcaktuara në Traktatin e Maastricht-it. Nga pikëpamja e Bankës së Shqipërisë, ruajtja e stabilitetit të çmimeve në nivele të përafërta me vlerën e referencës së zonës së Euros, është parësore. Përcaktimi i normës vjetore të inflacionit në nivelin rreth 3 për qind, duke qenë pranë niveleve të këtij treguesi për zonën e Euros, lejon

⁸⁹ Robert A. Feldman and Heliodoro Temprano-Arroyo, 1998, "Impact of EMU on selected country groups" IMF WP/98/82.

njëkohësisht për një përshtatje graduale të çmimeve relative⁹⁰ me zonën e Euros. Ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve, në kushtet e një kursi këmbimi stabël, do të bëjë kështu të mundur, një ngushtim gradual të diferencës së normave të interesave.

Arritja e këtyre synimeve përbën angazhimin e punës sonë në një afat të mesëm. Megjithëse ekonomia shqiptare ka bërë hapa të rëndësishëm në transformimin ekonomik, reforma të rëndësishme strukturore ende janë të prishme në vitet në vazhdim. Ato përmbajnë potenciale të mjaftueshme për më shumë presione inflacioniste, të cilat do të jetë e nevojshme të akomodohen me një koordinim më të kujdesshëm të politikave fiskale dhe monetare. Nga ana tjetër, çështjet e konvergjencës reale, si për shembull, të strukturave ekonomike, të nivelit të të ardhurave etj., do të kërkojnë edhe më shumë kohë sesa përmbushja e kriterëve normative të konvergjencës.

Një element i rëndësishëm i konvergjencës reale, janë përafrimet e **strukturave dhe të tregjeve financiare** si dhe harmonizimi i legjislacionit financiar.

Ne dëgjuam në seancat e kësaj konference prezantime që përshkruan në mënyrë të hollësishme zhvillimet në sektorin bankar të vendit. Prandaj, dëshiroj që këtu të fokusohem më tepër në disa probleme të liberalizimit të tregut financiar në përgjithësi dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit.

Legjislacioni mbi sistemin bankar të vendit është rishikuar dhe përsosur në mënyrë të vazhdueshme, duke bërë që në bisedimet për anëtarësimin e vendit tonë në OBT, Shqipëria të përfaqësohej me një ofertë liberale në shërbimet bankare. Të vetmet kufizime që zbatohen janë:

- kërkesa që degët e bankave të huaja, të cilat operojnë në Shqipëri, të licencohen si "banka" nga Banka e Shqipërisë; dhe
- marrja e miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë për transferimin e kapitaleve jashtë vendit nga rezidentët.

Këto kufizime ne i konsiderojmë si një masë e nevojshme kujdesi për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e sistemit bankar, në kushtet aktuale të zhvillimit të standardeve dhe të praktikave të mbikëqyrjes. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë po studjon mundësinë e liberalizimit të plotë të llogarisë kapitale, më parë se afati dhjetëvjeçar që na është pranuar nga kjo marrëveshje.

⁹⁰ Philipp C. Rother, 2000, "Inflation in Albania", IMF WP/00/207.

Sistemi bankar shqiptar sot ka 13 banka të nivelit të dytë, nga të cilat vetëm njëra është me kapital tërësisht vendas, edhe kjo në prag të procesit të privatizimit me investitorë të huaj strategjikë. Prania e ndjeshme e kapitalit të huaj në këtë sektor, me një peshë specifike prej 84 për qind, përveçse pritet të gjenerojë efekte pozitive në ekonomi, kërkon, në anën tjetër, forcimin e rregullave të mbikëqyrjes. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që kemi lidhur me institucionet mbikëqyrëse të Greqisë dhe të Turqisë, si dhe po diskutojmë për marrëveshje të njëjtë me autoritetet bullgare dhe polake.

Struktura e sotme e sistemit financiar, duke qenë akoma e pazhvilluar dhe thuajse tërësisht e dominuar nga sistemi bankar, në një kuptim e lehtëson mbikëqyrjen financiare. Duke mos patur të zhvilluar një treg të letrave me vlerë, një bursë funksionale dhe kur ndërmjetësi financiar i kursimeve dhe investimeve realizohet vetëm nga sistemi bankar, akoma nuk është shumë emergjent rregullimi institucional i sistemit të mbikëqyrjes.

Përmirësimet e legjislationit bazë dhe të kuadrit rregullator të krijimit dhe funksionimit të tregut të kapitaleve dhe të ndërmjetësve financiarë, të realizuara së fundi, krijojnë një kuadër të rëndësishëm për diversifikimin e strukturës së sistemit financiar të vendit. Konsolidimi i sektorit privat të ekonomisë, nga ana tjetër, do të shtrojë nevojën e lindjes së instrumenteve të reja të financimit të biznesit, duke rritur kështu shkallën e sofistikimit të sistemit financiar.

Këto procese do të kërkojnë që vendi ynë të rishikojë strukturën e mbikëqyrjes së sistemit financiar, duke mbajtur në konsideratë standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit European dhe direktivat e Komisionit European në këtë fushë.

Stabiliteti i sistemit financiar varet, gjithashtu, nga politikat që ndjekin pronarët dhe administratorët e bankave dhe standardet dhe rregullat e mbikëqyrjes, të vendosura nga autoritetet e vendit. Ndërveprimi i tyre do të sigurojë besimin e publikut. Edhe në standardet më të mira të mbikëqyrjes, asnjëherë nuk do të mund të përjashtohet incidenca e problemeve në institucione të veçanta. Megjithatë, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera të vendit, do të jenë të detyruar të parandalojnë shtrirjen e problemeve të tilla në institucione të tjera financiare, duke vendosur rregulla që minimizojnë rrezikun e krizave financiare. Në këtë kontekst, reforma të rëndësishme strukturore do të jenë të kërkuara të

realizohen. Hapi i parë në këtë drejtim, me projektligjin "Për garantimin e depozitave", është hedhur.

Procesi i integritit të vendit në strukturat e Bashkimit Europian, përfshin jo vetëm reformat e brendshme ekonomike dhe përgatitjet individuale të vendit për anëtarësim. Ai përfshin njëkohësisht forcimin e kooperimit dhe bashkëpunimit rajonal. Iniciativat rajonale në kuadrin e Paktit të Stabilitetit i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi, dhe Shqipëria është një pjesëmarrëse aktive në këto procese. Duke synuar vazhdimisht pjesëmarrjen në proceset integruese, edhe Banka e Shqipërisë është aktive në të gjitha forumet dhe iniciativat e vendeve të rajonit të Ballkanit. Do të veçoja këtu Klubin e Guvernatorëve të vendeve të rajonit, që me veprimtarinë e tij të suksesshme disavjeçare është kthyer në një institucion që mbledh guvernatorët në diskutime eksperiencash dhe në bashkërendimin e asistencës së ndërsjellë. Edhe vetë pjesëmarrja Juaj sot në këtë tryezë diskutimi, të nderuar Guvernatorë, është dëshmi e marrëdhënieve pozitive të bashkëpunimit që ne kemi nisur dhe do të vazhdojmë në të ardhmen.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ajo ç'ka përmenda deri tani, zbulon veçse një pjesë të hapave të rëndësishëm që Shqipëria duhet të ndërmarrë në të ardhmen. Procesi i integritit do të jetë një proces i gjatë në kohë. Ne dëshirojmë dhe do të punojmë që të përshpejtojmë këto procese, duke ndjekur dhe monitoruar nga afër mundësitë dhe realitetet që do të ofrojë mjedisi ekonomik i vendit. Sot ekonomia shqiptare nuk ka më nevojë për "terapi", por për më shumë dinamizëm dhe partneritet.

Ne kemi jetuar për një kohë të gjatë në një tjetër sistem, në një sistem me rregulla dhe vlera të ndryshme. Megjithatë, aspirata e shprehur e shoqërisë shqiptare është dëshira për të ndërtuar një shoqëri që ndan të njëjtat vlera me ato të kombeve të përparuara europiane. Prandaj, shteti dhe institucionet shqiptare, nuk kanë as të drejtë dhe as justifikim, të privojnë njerëzit të jetojnë në një shoqëri më të mirë dhe më të përparuar.

Faleminderit !